

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria Ndërmarrja Publike për Energji Elektrike shoqëri aksionare me seli të regjistruar në rrugën Halkokondili 30, 10432, Athinë, Republika e Greqisë, dorëzuar përmes avokatit Kristijan Polenak nga Shoqëria e Avokatëve Polenak nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 03.10.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Ndërmarrja Publike për Energji Elektrike shoqëri aksionare me seli në rrugën Halkokondili 30, 10432, Athinë, Republika e Greqisë do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqëritë Feliks Renjuvabl Holdings S.R.L. me seli në Sheshin Charl de Goll 15, kati i 5-të, Qarku 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë dhe TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L. me seli në rrugën Primaverii 4B, kati 1, Reshita, Qarku Karash-Severin, Republika e Rumanisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimin në shumën prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumën prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 29.08.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) iu dorëzua njoftim për përqendrim nga Ndërmarrja Publike për Energji Elektrike shoqëri aksionare me seli në rrugën Halkokondili 30, 10432, Athinë, Republika e Greqisë, me të cilin Ndërmarrja Publike për Energji Elektrike shoqëri aksionare do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqëritë Feliks Renjuvabl Holdings S.R.L. me seli në Sheshin Charl de Goll 15, kati i 5-të, Qarku 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë dhe TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L. me seli në rrugën Primaverii 4B, kati 1, Reshita, Qarku Karas-Severin, Republika e Rumanisë, dhe kontroll indirekt mbi shoqëritë: Ovidiu Development S.A. me seli në rrugën Ion Ionesku De La Brad 2B, kati 2, zyra 1, Qarku 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë, Tomis Tim S.A. me seli në rrugën Ion Ionesku De La Brad 2B, kati 2, zyra 2, Qarku 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë dhe M.V. Tim Invest S.R.L. me seli në rrugën Ion Ionesku De La Brad 2B, kati 2, zyra 3, Qarku 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-Ndërmarrja Publike për Energji Elektrike shoqëri aksionare është një shoqëri aksionare greke, shoqëri tregtare publike që tregton në tregun kryesor të Bursës së Athinës dhe prodhuesi dhe

furnizuesi kryesor i energjisë elektrike në Greqi. Ndërmarrja Publike për Energji Elektrike shoqëri aksionare është shoqëria udhëheqëse e Grupit PPK.

Aktivitetet kryesore të Grupit PPK përfshijnë prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, në Greqi dhe në Rumani. Grupi PPK është aktiv edhe në shitjen me pakicë të pajisjeve elektrike dhe elektronikës.

Në Maqedoninë e Veriut, Ndërmarrja Publike për Energji Elektrike shoqëri aksionare ka drejtpërdrejt një shoqëri të varur të regjistruar - Shoqëria për tregti dhe shërbime ENERXHI DELIVERI SOLUSHNS SHA Shkup me adresë në rrugën Stoltenbergova nr.4, ndërtesa 1/B5-1 1/kati SU nr. 4, Qendër, Shkup, Maqedonia e Veriut dhe veprimtaria prioritare e regjistruar - tregtia e energjisë elektrike.

-Feliks Renjuvabl Holdings S.R.L. është një shoqëri holding.

TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L. operon një sistem hidroenergjetik që përfshin katër mikro-hidrocentrale dhe infrastrukturën e lidhur me kapacitet total të instaluar prej 21.984 MW në basenin pritës Resita së bashku me sistemin fotovoltaiik lundruar me kapacitet total të instaluar prej 0.99 MW dhe mikro-hidrocentralin Brezova 2 me kapacitet total të instaluar prej 0.367 MW.

-Tomis Tim S.A., Ovidiu Development S.A. dhe TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L., operojnë disa impiante të prodhimit të energjisë elektrike (centrale me erë, mikro-hidro dhe fotovoltaike) me kapacitet total prej afërsisht 629 MW. Projektet e tyre në zhvillim përfshijnë njësi fotovoltaike të prodhimit me kapacitet total të vlerësuar prej rreth 98 MW dhe një sistem të ruajtjes së baterive, i vlerësuar me fuqi të instaluar prej 91.44 MW.

Tomis Tim S.A. dhe Ovidiu Development aktualisht operojnë tre centrale me erë në komunat Fentenele, Gradina, Kogevalak dhe Istra, në qarkun Konstanca, Rumani me kapacitet total prej 600 MW, si vijon:

Centrale me erë dhe infrastrukturë e lidhur me fuqi totale të instaluar prej 252.5 MW të zhvilluara nga Ovidiu Development në komunat Fentenele, Gradina dhe Kogevalak, qarku Konstanca, Rumani, së bashku me sistemin e ruajtjes BESS prej 2.525 MW;

Centrale me erë dhe infrastrukturë e lidhur me fuqi totale të instaluar prej 262.5 MW të zhvilluara nga Tomis Tim S.A. në komunat Fentenele, Kogevalak dhe Istra, qarku Konstanca, Rumani së bashku me sistemin e ruajtjes BESS prej 2.625 MW; dhe

Centrale me erë dhe infrastrukturë e lidhur me fuqi totale të instaluar prej 85 MW të zhvilluara nga M.V. Tim Invest S.R.L. në komunën Fentenele, qarku konstanca, së bashku me sistemin e ruajtjes BESS prej 0.85 MW.

-M.V. Tim Invest S.R.L. është pronare e një prej parqeve me erë që menaxhohen nga Tomis Tim.

-TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L., Ovidiu Development S.A. dhe Tomis Tim S.A. janë gjithashtu përfitues të Skemës së Mbështetjes së Certifikatave të Gjelbra (Green Certificates Support Scheme) që është në fuqi në Rumani, e prezantuar me qëllim të nxitjes së investimeve në prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (energji elektrike nga BRE).

-Tomis Tim S.A. dhe Ovidiu Development zhvillojnë dy projekte fotovoltaike me kapacitet total të vlerësuar prej rreth 98 MW dhe një sistem të ruajtjes së baterive, i vlerësuar me fuqi të instaluar prej 91.44 MW:

Centrale fotovoltaike hibride dhe infrastrukturë e lidhur me kapacitet total të instaluar prej afërsisht 48.75 MW në komunën Gradina, qarku Konstanca;

Centrale fotovoltaike hibride dhe infrastrukturë e lidhur me kapacitet total të instaluar prej afërsisht 48.75 MW në komunën Beidaud, qarku Tulcea;

-Sistem i ruajtjes BESS me kapacitet total të instaluar prej afërsisht 91.44 MW në komunën Fentenele, qarku Konstanca.

Shoqëritë e synuara nuk kanë shoqëri të varura të regjistruara ose degë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска